

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, Te jete si më poshtë:

a) për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim

te jete 0,05% te bazes se taksese, e llogaritur kjo ne shumen 14 leke /m2

b) për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike

Shkalla e taksës te jete 0,2% te bazes se taksese e llogaritur kjo ne Shumen 56 leke/m2.

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Aneksi 2-Çmimet mesatare per meter katror sipërfaqe ndertimi per ndertesat jo per banim propozohet si me poshte:

a-cmimi per m2 eshte 1.5% me i larte se çmimi i sipërfaqeve te banimit subjektet per sherbime dhe tregeti kjo ne shumem 84 lek/m2

b-Çmimi per m2 sipërfaqe ndertimi per parkim te mbuluar ose bodrume familjare eshte 70% e taksese se ndertesese per banesat ose $14 \times 70\% = 9.8$ lek/2 ndersa per parkim te hapur familjar =4.2 lek m2 , cmimi per parkim te hapur biznes =16.8 lek m2, -cmimi per parkim te mbuluar ose bodrum per biznes =39.2 lek/m2

c-Çmimi per m2 e sipërfaqeve ndertimi e destinuar per veprimtari prodhuese eshte 50% e cmimit te banesave ne zonen ku ushtron aktivitetin ose ne Shumen $56 \times 50\% = 28$ lek/m2

d-Cmimi per m2 e sipërfaqeve te ndertimit e destinuar per veprimtari industrial te jete sa 50% te taksese per tregti e sherbime ose $42 \times 50\% = 28$ lek/m2

d-Çmimi per m2 sipërfaqe ndertimi qe perdoren per bujqesi dhe blegtori eshte sa 30% e cmimit te sipërfaqeve te banesave te zones ose $56 \times 30\% = 16.8$ leke

e- Per ndertesat e privatizuara me ligjin nr 7652, date 23.12.1992 “ Per privatizimin e banesave shteterore”, I ndryshuar, cmimi per m2 eshte 70% I cmimit per m2 sipas zones ku ben pjese kjo ndertese = $14 \times 70\% = 9.8$ lek/m2.

Taksese mbi ndertesat i nenshtrohen individet, personat fizike dhe juridike, vendas apo te huaj, pronare ose perdorues te pasurive te paluajtshme ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht nga niveli i shfrytezimit te ketyre ndertesave, pervec rasteve kur ne ligj percaktohen ndryshe.

Kesaj takse i nenshtrohen edhe personat qe kane aplikuar per legalizim te ndertesese.

Gjithashtu taksese se ndertesese i nenshtrohen zhvilluesit, te cilet nuk e kane mbyllur ndertimin sipas lejes perkatese. Afati i perlllogaritjes fillon nga moment i mbarimit te afatit te lejes se ndertimit e percaktuar kjo ne miratimin e lejes se ndertimit.

Taksa vendore mbi pasurine –ndertese llogaritet si detyrim vjetor per taksapaguesit dhe duhet te likujdohet brenda 3 –mujorit te pare te vitit 2021.

Detyrimi per taksen mbi ndertesat llogaritet si shumezim i bazes se takses me shkallen e kesaj takes.

___TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Kjo takse eshte bazuar mbi ligjin nr 9632 date 30.10.2006 neni 23 dhe ne **Aneksin 2 Zona 1 dhe 2**, ndryshuar me Ligjin 142/2015 date 17.12.2015 . Baza e takses mbi token bujqesore eshte siperfaqja e tokes bujqesore ne Ha ne pronesi dhe ne perdorim,perfituar nga ligji nr.7501, date 19.07.1991 “ Per Token ” .e cila percaktohet sipas dokumentave qe e vertetojne ate.

Dokumentacioni per efekt te takses se tokes bujqesore eshte:

- Vertetimin e pronesise sipas Regjistrimit te Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme e cila njofton rregullisht cdo tre muaj pa shperblim Bashkine per ndryshimet dhe regjistrimet e reja (neni 24 i ligjit nr 9632 date 30.10.2006).
- Siperfaqja e tokes bujqesore percaktohet mbi bazen e dokumentave te pronesise, (ligji nr 7501 , date 19.07.1991 formulari 6, akti i pronesise).
- Per vertetim pronesie njihet edhe VKKKP, vendimet e privatizimit, vendimet e privatizimit (A K P) ose dokumenta te tjera te leshuara nga organet perkatese shteterore ne perputhje me legjislacionin perkates.
- Ne rast te mungeses se dokumentacionit , Kryetari i Bashkise ngre komision per verifikimin e pasurive te paluajtshme dhe taksimi behet mbi te dhenat qe leshon ky komision.

Kategorite minimale te tokave bujqesore jepen ne aneksin 2 te ligjit nr 142/2015 .Per cdo kategori minimale te tokes bujqesore , keshilli bashkiak mund te miratoje nenkategorizime.

Perjashtohen nga taksa e tokat bujqesore qe mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari per pese vitet e para nga koha e mbjelljes, dhe invalidet, te verberit, paraplegjiket dhe tetraplegjiket.

___Dokumentacioni per efekt perjashtimi nga taksa e tokes bujqesore eshte :

- ❖ **Fotokopje e librezes perkatese dhe vertetim nga dega e shoqates se invalideve, te verberve, apo tetra dhe paraplegjik (liste zyrtare per efekt te perjashtimit).**
- ❖ Taksa e mbledhur paguhet ne buxhetin e Bashkise ne teritorin e se ciles ndodhet prona e taksueshme.

Per fshatrat qe jane te rrethit Sarande do te bazohemi tek aneksi 2 zona 1 kategoria e peste deri tek kategoria e dhjete , dhe per fshatrat qe jane te rrethit Delvine do te bazohemi tek aneksi 2 zona 2 nga kategoria e trete deri tek kategoria e dhjete, e percaktuar per cdo njesi administrative dhe per cdo fshat taksa e tokes bujqesore eshte si me poshte:

Tarifa per sherbime te ndryshme administrative , pergatitja e dokumentacionit per token bujqesore per ne Z.R.P.P te jete 5000 leke.

___ **Njesia Administrative Finiq** ___ Finiq_2550 leke/ha/vit, Vrion_2600_ leke/ha/vit, Karahaxh_2500 leke/ha/vit, Bregas_2500 lek/ha/vit , Çlirim_2300 lek/ha/vit, Buronje _2600 leke/ha/vit.

___ **Njesia Administrative Livadhja** ___ Kalcat_2000 l/ha/vit, Llazat_2000 l/ha/vit, Sopik_2500 l/ha/vit, Lefter Talo_2400 l/ha/vit , Kullurice_2500 l/ha/vit , Koder_2200 l/ha/vit , Vagalat_2500 l/ha/vit , Pandalejmon_2500 l/ha/vit , **Grave_2000 l/ha/vit , Komat_2000 l/ha/vit** , Zminec_1800 l/ha/vit , Grazhdan_1800 l/ha/vit , **Qesarat_2000 l/ha/vit** , Karroq_1800 l/ha/vit , Livadhja_2500 l/ha/vit.

___ **Njesia Administrative Aliko** ___ **Halo_2800 l/ha/vit** , Pllake_2800 l/ha/vit , Fanar-3000 l/ha/vit , Qenurjo_3000 l/ha/vit , **Tremul_2800 l/ha/vit** , Rahulle_2800 l/ha/vit , Neohor_3000 l/ha/vit , **Jerme_2800 l/ha/vit** , Caush_3000 l/ha/vit , Aliko_3000 l/ha/vit.

___ **Njesia Administrative Dhiver** ___ Dhiver_1900 l/ha/vit , Navarice_2000 l/ha/vit , **Rumanxa_2000 l/ha/vit** , Memoraq_2200 l/ha/vit , Dermish_2200 l/ha/vit , Cerkovice_1800 l/ha/vit , **Shendre_1800 l/ha/vit** , Janicat_1800 l/ha/vit , Leshnice e poshtme dhe e siperme_1800 l/ha/vit , Malcan_1800 l/ha/vit.

___ **Njesia Administrative Mesopotam** ___ Krane_2600 l/ha/vit , **Ardhasove_2600 l/ha/vit** , Fitore_2550 l/ha/vit , **Livine_2300 l/ha/vit** , Kardhikaq_1600 l/ha/vit , Velahove_2000 l/ha/vit , Mesopotam_2650 l/ha/vit , Kostar_2300 l/ha/vit , Brailat_2400 l/ha/vit , Sirakat_2000 l/ha/vit , Krongj_1600 l/ha/vit , Dhrovjan_1600 l/ha/vit , Muzine_1600 l/ha/vit , Pece_1600 l/ha/vit , kurse ne fshatin Bistrice nuk kane perfituar toke bujqesore nga ligji nr 7501, date 19.07.1991 “ Per Token ” .

___ **TARIFAT QE DO TE PERDOREN PER UJITJEN E TOKAVE BUJQESORE**

___ Per ujitjen e tokave me rrjedhje te lire ku ujin e marrin fshataret pa shpenzime energjie tarifa do te jete ___ 2000 leke/ha/sezoni
___ per ujitjen e tokave ku fshataret bejne shpenzime energjie tarifa do te jete ___ 1000 leke/ha/sezoni.
Shtojme qe gjate procesit te ujitjes per cdo fshat do te behet konvertimi I tarifes ne vartesi te siperfaqjes se mbjelle dhe menyres se ujitjes sipas listes bashkelidhur paketes fiskale e perpiluar nga Drejtoria e Bujqesise dhe e Kullimit.
-----Per pike lidhje ne ujesjellesit e rezervuareve poshte saracineskes se ujesjellesit tarifa te jete 1500 leke .

Per administrimin e kesaj tarife do te bashkepunojne Drejtoria e Bujqesise , Drejtoria e Menaxhimit te Ujerave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

___ **TAKSA MBI TRUALLIN (JO HAPESIRE PUBLIKE)**

Kjo takse e shtuar me ligjin 142/2015 date 17.12.2015. Baza e taksës mbi truallin është siperfaqja e truallit ne m2 ne pronesi apo perdorim te taksapaguesit , e cila percaktohet me dokumenta qe e vertetojne ate. Ne rast mungese , perdoruesi ben vetdeklarim te siperfaqes ne perdorim, prane bashkise ku ndodhet trualli.Per cdo kategori keshilli bashkiak mund te miratoje nenkategorizime.Taksa eshte ne leke per meter katror.

Nivelet tregues te takses se truallit jepen ne aneksin 2.1 te ketij ligji. Taksa paguhet ne buxhetin e Bashkise , ne territorin ku ndodhet prona e taksueshme.

Per administrimin e kesaj tarife do te bashkepunojne Drejtoria e Bujqesise , Drejtoria e Menaxhimit te Ujerave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

LLOJI I TAKSES	NJESIA	TAKSA E TRUALLIT
<i>TRUALL PER QELLIME BANIMI NGA INDIVIDET</i>	<i>Leke/m2/vit</i>	<i>0.14</i>
<i>TRUALL PER QELLIME BIZNESI</i>	<i>Leke/m2/vit</i>	<i>12</i>